

KONKLuzionet Operacionale te Mbledhjes së Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur

DATA: 24/03//2023

KRYESOHET: Znj. Milva EKONOMI, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve, Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP)

MBLEDHJA: No.4

ÇËSHTJET E DISKUTUARA:

Çështja. 1: Informim mbi procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të Komitetit Shumëpalësh

Çështja. 2: Prezantimi i hapave të ndërmarrë në lidhje me procesin e hartimit dhe konsultimit publik të draft-Planit dy vjeçar Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur

Çështja. 3: Diskutim dhe miratim i draft-Planit dy vjeçar Kombëtar të Veprimit OGP

KONKLuzionet

1. Në përputhje me pikat e axhendës, përditësimi i informacionit në lidhje me anëtarët e rinj, përfaqësues të Shoqërisë Civile në Komitetin OGP, u krye nga përfaqësuesja e AMSHC, znj. Deasareta Lameborshi. Duke qenë se procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Shoqërisë Civile (përcaktuar me ligjin Nr.119/2015¹), të cilët përzgjedhin edhe anëtarët e Komitetit OGP, është shtyrë deri në maj 2023, u përcaktua dhe miratua që trajnimi për OGPnë që do të kryhet nga RESPA, të zhvillohet në maj, pas zgjedhjes së anëtarëve të rinj të OSHCve në Komitetin OGP.
2. Rrjeti me pikat fokale për Shoqërinë Civile në cdo ministri linje, si një iniciativë e kërkuar nga anëtarët e Shoqërisë Civile pjesëtarë në Komitetin OGP, është ngritur, sic edhe informuar nga Koordinatorja Kombëtare për Iniciativën për Qeverisje të Hapur (OGP) Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve.
3. Procesi i konsultimit publik për draft-Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur nga Znj. Milva Ekonomi, Ministër Shteti për Standardet e Shërbimeve. Procesi konsistoi në konsultimin e brendshëm ndërinstitucional, të zhvilluar me disa raunde takimesh e diskutimesh, si edhe në konsultimin me aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit që konsistoi në disa faza, në përputhje me Planin e Punës të miratuar në Komitetin.
4. Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin e Planit dy vjeçar Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur, duke përfshirë edhe disa sugjerime të sjella nga

¹ Ligji Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”

Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të paraqitura nga zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë në takimin e Komitetit OGP.

5. Dërgimi i dokumentit final Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur për Zyrat Qendrore OGP, të do të kryhet datën 27 mars nga Kabineti i Ministrisë të Shtetit për Standardet e Shërbimeve. Kjo datë shënon edhe datën e fillimit të Forumit për Demokraci në Washington D.C., ku do të jetë i pranishëm Kryeministri dhe do të raportojë mbi finalizimin e Planit Kombëtar të Veprimit për OGP.
6. Anëtarët e Komitetit aprovuan dokumentin Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur dhe në përputhje me procedurat paketa publikohet nga AKSHI në faqen www.ogp.al